

TV debat rajonal në Kumanovë: A jeton Kumanova në frymën e mirëkuptimit multi-etnik?

Më 30.11.2007 me fillim në ora 21:00 në TV Nova Kumanovë u emitua TV debati me titull "A jeton Kumanova në frymën e mirëkuptimit multi-etnik?". Qëllimi i këtij debati ishte të promovohet mirëkuptimi multi-etnik dhe të bisedohet për çështje që kanë të bëjnë me bashkësitë etnike jo shumicë në Kumanovë.

Në kontakt emisionin e hapur fjalime mbajtën Zoran Petrushevski, Kryetar i Këshillit të Komunës së Kumanovës, Naser Vejseli, Zëvendës Avokati i Popullit për rajonin e Kumanovës dhe përfaqësuesit e sektori joqeveritar: Sonja Arsovska nga SOS telefoni në Kumanovë, Bajram Sulejmani nga Natyra Likovë dhe Ahmet Jasharovski nga DROM Kumanovë.

Sipas bashkëbiseduesve, Kumanova është mjedis në të cilin jetojnë njerëz nga më shumë bashkësi etnike dhe është komuna e dytë më e madhe në të cilën jetojnë 60,5% maqedonas, 26% shqiptarë, serbë 8,5%, 4% romë, turq, vllah dhe boshnjak.

Kryetari i Këshillit të komunës foli për aktivitetet e ndërmarra nga komuna në drejtim të përmirësimit të jetës multi-etnike në Kumanovë. Ahmed Jasharovski e theksoi bashkëpunimin e Këshillit të komunës gjatë përpilimit të planeve lokale aksionare për Dekadën e Romëve, si edhe nevojën për implementimin e tyre në kontekst të nevojave dhe problemeve me të cilët ballafaqohen romët. Sonja Arsovska dhe Bajram Sulejmani i shprehën qëndrimet dhe mendimet e tyre për jetën multi-etnike në Kumanovë, duke folur për ndarjet mes nxënësve shqiptarë dhe maqedonas dhe për orvatjet që duhet bërë për tu integruar ato. Naser Vejseli e prezantoi punën e zyrës rajonale të Avokatit të Popullit në Kumanovë dhe mënyrat për marrjen e ndihmës nga ky institucion.

Konkludimi gjeneral ishte se Kumanova jeton në frymën e mirëkuptimit multi-etnik, kurse në Këshilli e komunës janë kyçur përfaqësues të gjitha bashkësive etnike joshumicë. Megjithatë, të pranishmit u pajtuan se akoma duhet të punohet në këtë fushë.

Udhëheqës i TV debatit ishte Snezhana Petkovska, gazetare në TV Nova Kumanovë.

Debati u emitua përsëri më 5 dhe 8 dhjetor të vitit 2007.